

PROCES VERBAL- Tipi i kontratës -

“Blerje rërë për plazhet publike ”

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS : “Blerje rërë për plazhet publike ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : Rere
14211000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 083 330 (dymilion tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë) Lekë
pa T.V.SH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Sarande ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar), nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur/fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2024,2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar) është përcaktuar që kontratat e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera materiale 1 (nje) mjet transporti mallrash me kapacitet jo më pak se 10 m³.

Per mjetin në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit;b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit. Për mjetin e marre me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm), e) foto e

automjetit . Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.

Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit). Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Ne zbatim te ketyre ndryshimeve ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne renditje pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezoje prane AK, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion nje mjet transporti me kapacitet mbajtes jo me pak se 1,5 ton, i nevojshem për kryerjen e transportit te mallrave objekt prokurimi.

SPECIFIKIME TEKNIKE

- Rere e lare lumi:

Karrier lumi;

Materiali inert duhet te jete nga karrier lumi e licencuar sipas legjislacionit ne fuqi me leje minerare.

Kerkesat e granulometrise

Rëra duhet të jetë rërë natyrore lumi, e lare ne lavatrice e kaluar ne makineri, e përbërë nga grimca të forta dhe të pastra, të qarta në ngjyrë dhe në formë sferike.

Rëra duhet të jetë e pastër dhe pa substanca organike, baltë, apo papastërti të tjera.

Përbërja e granulimit të rërës duhet të jetë me një granulim nga 1 mm deri në 7 mm.

Vendi I dorzimit te mallit do te jete sipas hartave bashkengjitur.

- Plazhi publik Bulevardi Naim Frasheri Sarande



- Plazhi publik Bulevardi Hasan Tahsini Sarande



- Plazhi publik Ksamil



Hartimi i specifikimeve teknike është në përputhje me parashikimet e nenit 36 të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Afati i shërbimit do të jetë 30 dite nga momenti i lidhjes së kontratës.